



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Raport i Dëgjimit Buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023

Takimi i dëgjimit buxhetor është mbajtur në Sallën në Kulturës në Drenas, për shkak të mbajtës së distancës mes pjesëmarrësve dhe të pranishëm ishin; nënkryetari i Komunës, Nazmi Hasi, drejtor të drejtorive komunale, administratorë të vendbanimeve dhe qytetarë. Ftesa për dëgjimin buxhetor për të diskutuar draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023 është bërë me kohë, ashtu siç parashihet me Ligj dhe është publikuar në ueb faqen zyrtare, në rrjetin social Facebook, në tabelën e njoftimeve para objektivit të Komunës dhe në portale.

Dëgjimi buxhetor ka pasur këtë rend dite për diskutim: Diskutim lidhur me Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023 dhe Draft-Lista e Investimeve Kapitale për këto vite

Dëgjimin buxhetor e ka hapur, Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, ndërsa të pranishmëve i është paraqitur informata e detajuar e buxhetit të planifikuar për vitin 2021 dhe projeksionet për vitet 2022-2023, po ashtu ata para vetës kanë pasur për diskutim edhe draft-listën e investimeve kapitale për vitet 2021-2023.

Nënkryetari Nazmi Hasi ka kërkuar nga të pranishmit të paraqesin sugjerimet dhe rekomandimet e tyre lidhur me vendbanimet që ata përfaqësojnë në mënyrë që të përfshihen në planin buxhetor për vitet 2021-2021.

Ndërsa, Drejtori për Buxhet e Financa, Shyqiri Bublatku njoftoi të pranishmit buxheti është hartuar në bazë të kufijve të përcaktuar nga Qarkorja Buxhetore 2021/01 të lëshuar nga Ministria e Financave. “Komuna e Drenasit përbehen buxhetin në tre sektorë, buxheti në sektorin e Administratës për vitin 2021 ka të planifikuar mjetet prej 7,169,887 euro me gjithë të hyrat vetanake, për vitin 2022 projeksioni i buxhetit nga kjo kategori është prej 7,539,731 dhe për vitin 2023 7,962,939 euro. Sektori i Arsimit buxhetin për vitin 2021 e ka të planifikuar prej 6,472,573 euro, për vitin 2022, shuma prej 7,039,890 dhe për vitin 2023 7,070,544 euro. Sektori i Shëndetësisë për vitin 2021 planifikimin e buxhetit e ka në vlerën prej 2,084,614, për vitin 2022 2,939,945 euro dhe për vitin 2023 projeksioni në vlerën prej 2,956,474 euro. Shprehur në total, Komuna e Drenasit për vitin 2021 ka një buxhet bukur me të vogël se vitin aktual dhe buxheti i përgjithshëm është 15,727,074 euro, kurse buxheti për vitin 2020 buxheti ka qenë në shumën prej 16,490,343 euro. Ndërsa në vitin 2022, buxheti i komunës rritet prap dhe kemi një buxhet në vlerën totale prej 17,519,566, kurse projeksioni për vitin 2023 buxheti shënon sërish një rritje dhe vlera totale është 17,989,957 euro”, ka njoftuar drejtori Bublatku.

Albert Nika – administrator i fshatit Gllanasellë – ka paraqitur kërkesat e banorëve si në vijim:

Kërkojë të vazhdohet me asfaltimin e rrugicave në lagjen Nika aty ku kanë mbetur ende në gjysmë, vazhdimi i asfaltimit të tri rrugicave të lagjes Krasniqi, një pjesë e saj ka mbetur vetëm me zhavor dhe nuk ka përfunduar, ndërsa dy rrugica të tjera kanë mbetur ende pa përfunduar dhe që nga përfundimi i luftës në këto pjesë nuk ka pasur as edhe shtrim të zhavorit. Vazhdimi i asfaltimit të rrugicës në lagjen Berisha që ka mbetur vetëm 250 metra, asfaltimi i tri rrugicave në lagjen Karaqica, asfaltimi i rrugicave në lagjen Llugani, asfaltimi i rrugicave në lagjen Maloku, asfaltimi i rrugicave në lagjen Kurrumeli, asfaltimi i rrugicave në lagjen Topilla që lidhet me lagjen Karaqica, renovimi i ambulantës në fshatin Gllanasellë duke pas parasysh gjendjen gjeografike të fshatit, renovimi i këtij objekti është shumë më rendësi të veçantë sepse munden me kry shërbime në këtë ambulantë edhe banorët e fshatit Godanc, Likoshan e Gradicë, prandaj është më rendësi të rinovohet kjo ambulantë si dhe të krijohet mundësia që të paktën një herë në javë të kryhen analizat në këtë objekt, sepse objekti ka hapësirë dhe i plotëson nevojat vetëm duhet një investim nga ana e Komunës. Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në fshatin Gllanasellë që lidh me fshatin Godanc ku kjo rrugë ka mbetur ende e pa përfunduar, rregullimi i kanalizimit të lagjes Maloku, Krasniqi, Kurrumeli si dhe rregullimi i kanalizimit të lagjes Nika, nuk ka metra shumë, por me pak metra kryhen të gjitha lagjet. Gjithashtu përfundimi i rregullimit të rrugës me kubëza në lagjen Nika që ka mbetur në gjysmë, ju inkurajoj që pjesa që ka mbetur me trotuar të mbahet 3 metra sepse po cenohet liria e lëvizjes së bujqëve, prandaj shikoni mundësitë buxhetore dhe gjatë vitit 2021 të kryhet ajo pjesë. Një falënderim i veçantë për Shtabin Emergjent të Komunës së Drenasit që gjatë kohës së pandemisë, ka ndihmuar banorët e fshatit Gllanasellë me pako ushqimore-higjienike.

Lidhur me këto kërkesa, u mbajtë shënim dhe u adresuan tek drejtoritë përkatëse.

Bajram Qallapeku – administratorë në fshatin Tërstenik II ka paraqitur disa kërkesa për projektet në këtë fshat:

Lagja Strumcaku ka nevojë për 350 metra asfalt, po ashtu rruga në lagjen Qallapeku që lidh lagjen Kuqican, i kemi 300 metra asfalt të lagja Qallapeku janë 300 metra pa asfalt, të Bazajt 200 metra, po ashtu është e nevojshme edhe të lagja Arllati disa metra. Kemi disa probleme me rrjet të kanalizimit në disa lagje ende nuk është kryer, po ashtu kemi probleme me ujësjellës, nuk kemi ujë të pijshëm. Kisha propozu të formohet një komision nga Komuna që të ndahet buxheti proporcion sipas banorëve dhe me prioritet.

Lidhur me këtë kërkesë u njoftuan drejtoritë përkatëse për përfshirjen e tyre në KAB.

Kadri Ajazi – administrator nga fshati Sankoc ka paraqitur disa kërkesa të banorëve si asfaltime të rrugëve, kanalizim dhe ujësjellës.

Asfaltimi i rrugës në lagjen Gjoshi dhe Pirraku ka mbetur në gjysmë dhe ka nevojë të ndahen mjete shtesë që kjo rrugë të përfundoj, përafërsisht janë 500 metra, ndërsa vitin e kaluar vetëm 200 metra janë shtruar. Po ashtu fshati ka nevojë për asfaltim të rrugicave në lagjen Isufi, në lagjen Likaj dhe lagja Ramaj. Me 2500 metra kryhen të gjitha rrugicat në fshatin tonë. Sa i përket rrjetit të kanalizimit, një pjesë e madhe e lagjeve janë kryer, por e kemi ende të pa përfshinë lagjen Ramaj që janë të nevojshme edhe mbi 2000 metra shtrirje të rrjetit të kanalizimit. Në lagjen Gjoshi, të gjitha livadhet e fshatit, janë të mbuluara nga kanalizimet që derdhen aty dhe banorët nuk po mundën me i krye punët e tyre bujqësore. Kisha kërkuar nga ana juaj që të përfshihen projektet që i përmenda më herët, po ashtu nuk kemi as trotuare të shturara në fshat edhe pse nevoja është e madhe sepse frekuentimi i njerëzve e edhe i nxënësve është shumë i madh dhe ka nevojë për trotuar në shumë lagje të fshatit. Fshati ka nevojë shumë edhe për rrjetin e ujësjellësit, të shtrihen gypat sepse fshati ka kanalin e bollshëm të ujit ku mundemi të furnizohemi, është nga Goleshi, por vetëm kërkohet investimi nga ana e Komunës.

Lidhur me këto kërkesa është mbajtur shënim për tu adresuar sipas natyrës së kërkesave nëpër drejtoritë komunale.

Imri Bajraktari – administrator i fshatit Kizhnarekë në këtë takim paraqiti disa kërkesa si lagje të papërfshira në rrjetin e kanalizimit.

Kemi ende shumë lagje të pa përfshira në rrjetin e kanalizimit, vitin e kaluar kanë qenë të planifikuara 500 metra edhe ato nuk janë realizuar, sepse ato metra kanë shkuar në kanalizimin e fshatit Nekoc e Sankoc. Sa i përket rrjetit të kanalizimit, fshati ka një pozitë gjeografike që mundën të gjitha kanalizimet të shtrihen përkaj lumit që kalon përmes fshatit, por që lumi ende nuk është rregulluar. Kemi nevojë për rrjet të kanalizimit nga lagja Bajraktari deri të Xhamia e fshatit, pastaj prej varrezave deri të udhëkryqi, lagja Qelaj nuk ka fare kanalizim, pra kemi tri lagje që kanë kanalizim. Po ashtu kemi shumë rrugica në fshat që nuk kanë asfalt, kemi lagjen Sylja, lagja e Berishve në të dy anët e po ashtu edhe lagja Sylajve që ka nevojë për asfaltim.

Edhe për këtë pikë, këto kërkesa u adresuan tek Drejtoria e Infrastrukturës dhe e Shërbimeve Publike.

Samedin Kiqina – administrator i fshatit Baicë paraqiti projektet prioritare të fshatit si në vijim:

Kanalizimi në lagjen Leku që është e pa lidhur, lagja Kiqina e që të njihet si lagja e Zhubve po ashtu ka nevojë për rrjet të kanalizimit, lagja Halimi, lagja Vrellaku, lagja Zariqi dhe lagja Elshani që po ashtu janë 12 shtëpi që nuk kanë mundur me u përfshi në rrjet të kanalizimit. Sa i përket asfaltimit, kemi lagjen Topalli që ka nevojë për asfaltim, janë nja 300 metra që kurrë nuk është investuar atë lagje, pastaj rruga “Sadik Leku” nga vorret deri të Lant kemi nevojë që ajo pjesë të shtrohet, janë dikur afër 500 metra. Kemi lagjen Vrellaku që po ashtu ka nevojë për asfaltim, lagjen Halimi dhe lagjen Zariqi, pastaj rruga “Vëllëzeir Elshani” është e pa

kalueshme, te ne njihet si lagja Elshani, janë rreth 200 metra prandaj kërkoj që të paktën të behët e kalueshme me zhavor. Fshati ka nevojë të madhe për ujë të pijshëm, pjesa më e madhe e fshatit nuk ka ujë, projekti në vitin 2010 vetëm i ka varrosur gypat edhe kurr si kanë kry projektin dhe kanë mbetur vetëm në dhe ata gypa e nuk janë funksional asnjëri, kompania i ka këput në disa vende dhe kanë mbetur ne të njëjtën gjendje. Tjetër kemi nevojë në rrugën “Sylë Elshani”, që jeton një banor që ju ka maru shtëpia e nuk po mundet me hy në shtëpi për shkak të rrugës. E kemi një veteran që nuk po mundet me u lidh në rrjetin e kanalizimit. Kam shumë ankesa të dëshmuara edhe me foto për punimet në kanalizime që janë bërë keq, ka punuar kompania 7 ditë dhe janë shumë keq dhe kërkush nuk ka ardhur me e inspektu, punët në terren janë punuar keq dhe ne i kemi bërë disa herë kërkesa e ankesa, kompania shaktat i ka vendos në anën e kundër, gypat janë krejt në anën e kundërt, nuk ka shti shirit e as zhavor të mjaftueshëm, pra ka marr zhavor të mbeturinave dhe i ka mbulu cevati, e ka pre asfaltin në dy vende dhe nuk e ka bërë riparimin e rrugëve të dëmtuara, prandaj kisha kërkuar nga ana juaj që t’i inspektoni më shumë punimet dhe mos të kryhen punët në terren shkel e shko. Fshati Baicë është shumë i madh, kemi shumë lagje pa kanalizim, pa rrjet të ujësjellësit e pa asfaltim.

Lidhur me këtë çështje, u përgjigj Drejtori i Infrastrukturës i cili tregoj se cilat nga këto projekte janë në realizim e sipër sipas planifikimit buxhetor.

Ramadan Ramaj – përfaqësues në fshatin Tërdec paraqit ankesat për asfaltim të rrugicave në lagjen Halilaj, Ramaj dhe Xhekaj si dhe për kanalizimin në lagjen Halilaj.

Fadil Tiku – administratorë i fshatit Vërboc – kërkoj që në planin buxhetor të përfshihet asfaltimi i rrugës tek lagja Rrukiqi si dhe ujërat e zeza të cilat derdhen në tokat e tyre.

“Lagja Zhushi ka nevojë për asfaltim, lagja Krelani, po ashtu është e nevojshme të lidhet lagja e Gllareva me pishat në Gllobar”, paraqiti ndër të tjerash administratori i Verbocit.

Afrim Gjeli- administratorë i fshatit Poklek i Ri – e kam dorëzuar një kërkesë me 24 shkurt 2020 në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë dhe në Drejtorinë për Infrastrukturë Lokale, prandaj kërkoj që kjo kërkesë të realizohet, kërkesë tjetër kemi nga banorët e banesave në Poklek të Ri, që këto banesa ende nuk janë të pranuara teknikisht dhe kanë mbetur në pjesë e madhe të pa banuara, po ashtu nuk dihet ende se kush është pronari faktik i tyre dhe banorët kanë mbetur pa e zgjidhur ende çështjen e banimit.

Administratori Afrim Gjeli mori përgjigje nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe nga Drejtoria për Infrastrukturë Lokale.

Jahir Beqiqi – administratorë i Denasit II – Drenasi II ka nevojë për asfaltim të 4 rrugëve dhe një trotuar dhe kërkoj që të realizohen këto projekte, po ashtu Drenasi II ka nevojë për një çerdhe, ka qenë e planifikuar, por ende nuk është realizuar, prandaj kisha kërkuar që të realizohen kërkesat tona për vitin e ardhshëm.

Këto kërkesa u morën shënim për t’i përfshirë në planin buxhetor.

Këto kërkesa u morën shënim për t'i përfshirë në planin buxhetor.


Zekë Kluna – administratorë në fshatin Poklek i Vjetër – kisha me e nda një shqetësim lidhur me ujin e thart në Poklek, pse komuna ende nuk ka bërë asnjë investim në atë pjesë, kur duhet rëndësia e atij burimi natyral të ujit. Janë më dhjetëra gjenerata që kanë pi e furnizu me atë burim të ujit në Poklek e nuk i është dhënë rëndësia nga ana e Komunës për të rregulluar, ka mbetur sikur me qenë në një komunë tjetër ajo pjesë. Rruga në lagjen Muqolli nuk është kryer ende, vetëm do zhavor është vendosur dhe ka mbetur ashtu, po ashtu rrjeti i kanalizimit në Poklekun e Vjetër është në gjendje të mjerueshme dhe një pjesë e tyre derdhen direkt në këtë burim të ujit për pije dhe e ka bërë të pashfrytëzueshem këtë pasuri natyrore që ka fshati jonë, prandaj kisha kërkuar të dilni dhe të rregulloni atë pjesë dhe ti kthehet bukuria atij vendi siç ka qenë më herët.

Xhevdet Demaku – administratorë i fshatit Abri - prioritet i fshatit tonë është ujësjellësi, prandaj kisha kërkuar të njoftohem se rezervuari me kapacitet 350 ml litra, kur do të përfundohet dhe të realizohet. Prerja e rrugës në lagjen Demaku është për t'u intervenuar shumë shpejtë, kërkesa është bërë ka kohë, por ende nuk është kryer, po ashtu edhe lagja Hysenaj.

Edhe për këto kërkesa, administratori u njoftua nga Drejtori i Infrastrukturës dhe e njoftoi se të gjitha kërkesat e tyre do të përfshihen në planin e projekteve.

Raportin e hartoi:

Bekim Dobra, Shef i Zyrës së Informimit



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	09. 07 2020		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	- 060-	2759	



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit
Drenas, më 08.07.2020



PROCESVERBAL

i Dëgjimit Buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023

Takimi i dëgjimit buxhetor është mbajtur në Sallën ne Kulturës në Drenas, për shkak të mbajtës së distancës mes pjesëmarrësve dhe të pranishëm ishin; nënkryetari i Komunës, Nazmi Hasi, drejtor të drejtorive komunale, administratorë të vendbanimeve dhe qytetarë. Ftesa për dëgjimin buxhetor për të diskutuar draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023 është bërë me kohë, ashtu siç parashihet me Ligj dhe është publikuar në ueb faqen zyrtare, në rrjetin social Fecekook, në tabelën e njoftimeve para objektit të Komunës dhe në portale.

Dëgjimi buxhetor ka pasur këtë rend dite për diskutim: Diskutim lidhur me Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023 dhe Draft-Lista e Investimeve Kapitale për këto vite



Dëgjimin buxhetor e ka hapur, Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, ndërsa të pranishmëve i është paraqitur informata e detajuar e buxhetit të planifikuar për vitin 2021 dhe projeksionet për vitet 2022-2023, po ashtu ata para vetës kanë pasur për diskutim edhe draft-listën e investimeve kapitale për vitet 2021-2023.

Bekim Dobra – Jemi mbledhur sot ne këtë dëgjim buxhetor për të diskutuar Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023 si dhe Draft-Listën e Investimeve Kapitale për vitet 2021-2023. Ky dokument është përgatitur ne bazë të Qarkores Buxhetore 2021/01 të lëshuar nga

Ministria e Financave, e cila paraqet përmbledhjen e kërkesave fillestare të planifikimit e parashikimit për vitin 2021 dhe projeksionit të buxhetit për vitet 2022-2023. Komuna me kohë ka bërë njoftimin dhe ftesën. Që nga muaji Maj i këtij viti, pasi që kemi pranuar Qarkoren Buxhetore, kemi ftuar ekspertet, OJQ-të, Shoqërinë Civile dhe profesionistët për të kontribuar në hartimin e këtij dokumenti. Komuna e Drenasit shquhet për transparencë e llogaridhënie, ndaj me kohë këto dy dokumente, Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023 dhe draft-Listën e Investimeve Kapitale i ka publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës. Ndjej për obligim të ju njoftoj me rregullat e takimit, që diskutimet për buxhet të jenë reciproke me qëllim që të behët një përmbledhje me interes për të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit. Para vetës keni dy materiale, draft-listën e investimeve kapitale si dhe informatën se si është planifikuar të adresohet buxheti komunal për vitet në vazhdim. Të nderuar të pranishëm, fillimisht i jap fjalën nënkryetarit të Komunës, Nazmi Hasi për të përshëndetur takimin.

Nënkryetari i Komunës, Nazmi Hasi – së pari e përshëndes këtë takim dhe juve pjesëmarrës që keni gjetur kohën të jeni pjesë në diskutim për planifikimin e buxhetit të komunës për vitet në vazhdim. Ju e dini që aktet relevant e kanë përpiluar materialin e nevojshëm të buxhetit që sot mund të diskutojmë për zhvillimin e projekteve dhe të natyrave të tjera buxhetore. Ky dokument, ende ka formën e draftit dhe deri sa të merr formën finale të vendimit, juve të nderuar ju është dhënë e drejta për të dhënë propozimet e juaja lidhur me plotësimin e këtij dokumenti që të përfshihen të gjitha vendbanimet në këtë plan buxhetor për vitet në vazhdim në mënyrë që paraja publike të shpërndahet në lokalitetet ku nevojat dhe kërkesat janë të domosdoshme. Neve na nevojiten sugjerimet e juaja, rekomandimet e juaja, pastaj të kemi mundësin të japim formën finale. Një falënderim të veçantë është për juve të pranishmëve, që keni shprehur interesimin tuaj për zhvillimin e vendbanimit që përfaqësoni, prandaj nga kjo foltore, shfrytëzoj rastin që pa kurrfarë ngurrimi t'i paraqitni të gjitha brengat e juaja dhe të qytetarëve tuaj.

Drejtori për Buxhet e Financa, Shyqiri Bublaku – sa i përket draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021-2023, ju kisha njoftu që edhe komuna jonë, sikurse komunat tjera, kanë hartuar buxhetin sipas mundësive që ka, në bazë të kufijve të përcaktuar nga Qarkorja Buxhetore 2021/01 të lëshuar nga Ministria e Financave. Komuna e Drenasit përbehen buxhetin në tre sektorë, buxheti në sektorin e Administratës për vitin 2021 ka të planifikuar mjetet prej 7,169,887 euro me gjithë të hyrat vetanake, për vitin 2022 projeksioni i buxhetit nga kjo kategori është prej 7,539,731 dhe për vitin 2023 7,962,939 euro. Sektori i Arsimit buxhetin për vitin 2021 e ka të planifikuar prej 6,472,573 euro, për vitin 2022, shuma prej 7,039,890 dhe për vitin 2023 7,070,544 euro. Sektori i Shëndetësisë për vitin 2021 planifikimin e buxhetit e ka në vlerën prej 2,084,614, për vitin 2022 2,939,945 euro dhe për vitin 2023 projeksioni në vlerën prej 2,956,474 euro. Shprehur në total, Komuna e Drenasit për vitin 2021 ka një buxhet bukur me të vogël se vitin aktual dhe buxheti i përgjithshëm është 15,727,074 euro, kurse buxheti për vitin 2020 buxheti ka qenë në shumën prej 16,490,343 euro. Ndërsa në vitin 2022, buxheti i komunës rritet prapë dhe kemi një buxhet në vlerën totale prej 17,519,566, kurse projeksioni për vitin 2023 buxheti shënon sërish një rritje dhe vlera totale është 17,989,957 euro. Buxheti është i planifikuar në 5 kategori të shpenzimeve, në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, mallra dhe shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe investime kapitale.

Pandemia globale me covid-19 ka ndikuar që buxheti i komunës së Drenasit të zvogëlohet për vitin e ardhshëm që kryesisht kjo ka ndikuar nga të hyrat e ndryshme që ka shteti, si të hyrat doganore, tatimore por edhe nga të hyrat komunale, si tatimi në pronë dhe taksa të ndryshme ku kemi një rënie dhe kjo ka ndikuar që buxheti për vitin 2021 të jetë me i vogël dhe atë për 4.63% apo në vlerën prej 763,269.00 euro. Buxheti i komunës për vitin fiskal 2021 i planifikuar në shumën prej 15,727,074 euro për nga aspekti ekonomik i shpenzimit do të shpërndahe në 5 kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve, ndërsa për nga aspekti funksional në 20 programe e nënprograme buxhetore. Për vitin 2021 shpenzimet rrjedhëse (paga dhe mëditje, shpenzime për mallra dhe shërbime, shpenzime të shërbimeve komunale dhe subvencione-transfere) do të marrin pjesë në buxhet në vlerën prej 11,893,705.00 euro apo 75.62%, ndërsa shpenzimet kapitale planifikohen të marrin pjesë në vlerën prej 3,833,369.00 euro apo 24.37%. Ju e keni informatën se si do të rrjedh buxheti për këto vite e po ashtu edhe draft-listën e investimeve kapitale dhe besoj që keni pasur kohën e mjaftueshme për të parë dhe ne jemi këtu për të diskutuar secilën pyetje, sugjerime që bëni ne këtë takim.

Bekim Dobra – e ka hapur diskutimin lidhur me dëgjimin buxhetor dhe ka kërkuar nga të pranishmit që të prezantohen para së të marrin fjalën dhe të tregojnë se cilin vendbanim prezantojnë, pastaj pasi të përfundojnë të gjitha diskutimet, të ju përgjigjet gjithëscilit drejtori i Infrastrukturës Lokale, Endrit Gllareva.

Albert Nika – administrator i fshatit Gllanasellë – në secilin takim që është thirrur nga komuna, kam qenë pjesë për të përfaqësuar interesat e fshatit Gllanasellë dhe me kohë i kemi adresuar të gjitha problemet dhe kërkesat tona. Një pjesë e madhe e kërkesave tona që i kemi adresuar, kanë përfunduar, mirëpo disa kërkesa kur janë paraqitur në dëgjimet buxhetore janë kryer pjesërisht e disa nuk janë marr parasysh fare me arsyetimin në mungesë mjetesesh. Kam për obligim moral të paraqes të gjitha kërkesat që ka fshati Gllanasellë dhe do t'i paraqes të gjitha me radhë, ndërsa mundësitë tuaja buxhetore se sa keni mundësi, ajo është çështje tjetër, megjithatë unë do ti paraqes me radhë kërkesat. Kërkojë të vazhdohe me asfaltimin e rrugicave ne lagjen Nika aty ku kanë mbetur ende në gjysmë, vazhdimi i asfaltimit të tri rrugicave të lagjes Krasniqi, një pjesë e saj ka mbetur vetëm me zhavor dhe nuk ka përfunduar, ndërsa dy rrugica të tjera kanë mbetur ende pa përfunduar dhe që nga përfundimi i luftës në këto pjesë nuk ka pasur as edhe shtrim të zhavorit. Vazhdimi i asfaltimit të rrugicës në lagjen Berisha që ka mbetur vetëm 250 metra, asfaltimi i tri rrugicave në lagjen Kraqica, asfaltimi i rrugicave në lagjen Llugani, asfaltimi i rrugicave në lagjen Maloku, asfaltimi i rrugicave në lagjen Kurrumeli, asfaltimi i rrugicave në lagjen Topilla që lidhet me lagjen Kraqica, renovimi i ambulantes në fshatin Gllanasellë duke pas parasysh gjendjen gjeografike të fshatit, renovimi i këtij objekti është shumë më rendësi të veçantë sepse munden me kry shërbime në këtë ambulantë edhe banorët e fshatit Godanc, Likoshan e Gradicë, prandaj është më rendësi të rinovohet kjo ambulantë si dhe të krijohet mundësia që të paktën një herë në javë të kryhen analizat në këtë objekt, sepse objekti ka hapësirë dhe i plotëson nevojat vetëm duhet një investim nga ana e Komunës. Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në fshatin Gllanasellë që lidh me fshatin Godanc ku kjo rrugë ka mbetur ende e pa përfunduar, rregullimi i kanalizimit të lagjes Maloku, Krasniqi, Kurrumeli si dhe rregullimi i kanalizimit të lagjes Nika, nuk ka metra shumë, por me pak metra kryhen të gjitha lagjet. Gjithashtu përfundimi i rregullimit të rrugës me

kubëza në lagjen Nika që ka mbetur në gjysmë, ju inkurajoj që pjesa që ka mbetur me trotuar të mbahet 3 metra sepse po cenohet liria e lëvizjes së bujqëve, prandaj shikoni mundësitë buxhetore dhe gjatë vitit 2021 të kryhet ajo pjesë. Një falënderim i veçantë për Shtabin Emergjent të Komunës së Drenasit që gjatë kohës së pandemisë, ka ndihmuar banorët e fshatit Gllanasellë me pako ushqimore-higjienike.

Bajram Qallapeku – administratorë në fshatin Tërstenik II – unë sot kam para vetës disa kërkesa lidhur me projektet në fshatin tonë, kërkesat edhe vitin e kaluar i kam bërë, por disa kanë arritur të realizohen e disa ende jo. Po filloj nga lartë fshatit, lagja Strumcaku ka nevojë për 350 metra asfalt, po ashtu rruga në lagjen Qallapeku që lidh lagjen Kuqican, i kemi 300 metra asfalt të lagja Qallapeku janë 300 metra pa asfalt, të Bazajt 200 metra, po ashtu është e nevojshme edhe të lagja Arllati disa metra. Kemi disa probleme me rrjet të kanalizimit në disa lagje ende nuk është kryer, po ashtu kemi probleme me ujësjellës, nuk kemi ujë të pijshëm. Kisha propozu të formohet një komision nga Komuna që të ndahet buxheti proporcional sipas banorëve dhe me prioritet.

Kadri Ajazi – administrator nga fshati Sankoc – siç po i shoh projektet e planifikuara për vitin e ardhshëm, për fshatin tonë janë të pamjaftueshme, sepse kemi nevojë për më shumë projekte, sepse kërkesat janë të mëdha. Asfaltimi i rrugës në lagjen Gjoshi dhe Piraku ka mbetur në gjysmë dhe ka nevojë të ndahen mjete shtesë që kjo rrugë të përfundoj, përafërsisht janë 500 metra, ndërsa vitin e kaluar vetëm 200 metra janë shtruar. Po ashtu fshati ka nevojë për asfaltim të rrugicave në lagjen Isufi, në lagjen Likaj dhe lagja Ramaj. Me 2500 metra kryhen të gjitha rrugicat në fshatin tonë. Sa i përket rrjetit të kanalizimit, një pjesë e madhe e lagjeve janë kryer, por e kemi ende të pa përfshinë lagjen Ramaj që janë të nevojshme edhe mbi 2000 metra shtrirje të rrjetit të kanalizimit. Në lagjen Gjoshi, të gjitha livadhet e fshatit, janë të mbuluara nga kanalizimet që derdhen aty dhe banorët nuk po mundën me i krye punët e tyre bujqësore. Kisha kërkuar nga ana juaj që të përfshihen projektet që i përmenda më herët, po ashtu nuk kemi as trotuare të shtruar në fshat edhe pse nevoja është e madhe sepse frekuentimi i njerëzve e edhe i nxënësve është shumë i madh dhe ka nevojë për trotuar në shumë lagje të fshatit. Fshati ka nevojë shumë edhe për rrjetin e ujësjellësit, të shtrihen gypat sepse fshati ka kanalin e bollshëm të ujit ku mundemi të furnizohemi, është nga Goleshi, por vetëm kërkohet investimi nga ana e Komunës.

Imri Bajraktari – administrator i fshatit Kizhnarekë – në fshatin tonë nuk mundemi me thanë që nuk është punuar, por si fshat me realizim të projekteve ende jemi shumë larg. Kemi ende shumë lagje të pa përfshira në rrjetin e kanalizimit, vitin e kaluar kanë qenë të planifikuara 500 metra edhe ato nuk janë realizuar, sepse ato metra kanë shkuar në kanalizimin e fshatit Nekoc e Sankoc. Sa i përket rrjetit të kanalizimit, fshati ka një pozitë gjeografike që mundën të gjitha kanalizimet të shtrihen përkaj lumit që kalon përmes fshatit, por që lumi ende nuk është rregulluar. Kemi nevojë për rrjet të kanalizimit nga lagja Bajraktari deri të Xhamia e fshatit, pastaj prej varrezave deri të udhëkryqi, lagja Qelaj nuk ka fare kanalizim, pra kemi tri lagje që kanë kanalizim. Po ashtu kemi shumë rrugica në fshat që nuk kanë asfalt, kemi lagjen Sylaj, lagja e Berishve në të dy anët e po ashtu edhe lagja Sylajve që ka nevojë për asfaltim.

Samedin Kiqina – administrator i fshatit Baicë – fshati jonë ka shumë kërkesa, por do të mundohem t’i përfshijë në pesë pika kryesore të projekteve prioritare të fshatit. Kanalizimi në lagjen Leku që është e pa lidhur, lagja Kiqina e që te ne njihet si lagja e Zhubve po ashtu ka nevojë për rrjet të kanalizimit, lagja Halimi, lagja Vrellaku, lagja Zariqi dhe lagja Elshani që po ashtu janë 12 shtëpi që nuk kanë mundur me u përfshi në rrjet të kanalizimit. Sa i përket asfaltimi, kemi lagjen Topalli që ka nevojë për asfaltim, janë nja 300 metra që kurrë nuk është investuar atë lagje, pastaj rruga “Sadik Leku” nga varret deri të Lant kemi nevojë që ajo pjesë të shtrohet, janë dikur afër 500 metra. Kemi lagjen Vrellaku që po ashtu ka nevojë për asfaltim, lagjen Halimi dhe lagjen Zariqi, pastaj rruga “Vëllezërit Elshani” është e pa kalueshme, te ne njihet si lagja Elshani, janë rreth 200 metra prandaj kërkoj që të paktën të behët e kalueshme me zhavor. Fshati ka nevojë të madhe për ujë të pijshëm, pjesa më e madhe e fshatit nuk ka ujë, projekti në vitin 2010 vetëm i ka varrosur gypat edhe kurrë si kanë kry projektin dhe kanë mbetur vetëm në dhe ata gypa e nuk janë funksional asnjëri, kompania i ka kput në disa vende dhe kanë mbetur ne të njëjtën gjendje. Tjetër kemi nevojë në rrugën “Sylë Elshani”, që jeton një banor që ju ka maru shtëpia e nuk po mundet me hy në shtëpi për shkak të rrugës. E kemi një veteran që nuk po mundet me u lidh në rrjetin e kanalizimit. Kam shumë ankesa të dëshmuara edhe me foto për punimet në kanalizime që janë bërë keq, ka punuar kompania 7 ditë dhe janë shumë keq dhe kërkush nuk ka ardhur me e inspektu, punët në terren janë punuar keq dhe ne i kemi bërë disa herë kërkesa e ankesa, kompania shaktat i ka vendos në anën e kundër, gypat janë krejt në anën e kundërt, nuk ka shti shirit e as zhavor të mjaftueshëm, pra ka marr zhavor të mbeturinave dhe i ka mbulu cevat, e ka pre asfaltin në dy vende dhe nuk e ka bërë riparimin e rrugëve të dëmtuara, prandaj kisha kërkuar nga ana juaj që t’i inspektoni më shumë punimet dhe mos të kryhen punët në terren shkel e shko. Fshati Baicë është shumë i madh, kemi shumë lagje pa kanalizim, pa rrjet të ujësjellësit e pa asfaltim. Është punuar trotuari, për 4 muaj është dëmtuar komplet trotuari, me e këqyr në drita natën është bërë trotuari si valë deti, pra kompania ka kry punën shumë keq, prandaj merrni parasysh këto shqetësime se punimet në terren po kryhen shumë keq.

Ramadan Ramaj – përfaqësues në fshatin Tërdec - së pari kam vërejtje se ndarjet buxhetore nuk janë duke u bërë sipas kërkesave të fshatrave dhe po përfshihen nga dy fshatra, kemi në këtë lsi të projektin Abri-Tërdec, duhet të ndahen projektet për secilin fshat. Kërkesë primare e fshatit tonë është që rregullohet rrjeti i ujësjellësit në fshat, sepse ne ende nuk kemi ujë të pijshëm thuaje i gjithë fshati. Kemi nevojë për asfaltimin e rrugicave në 4 lagje, asfaltim në rrugën e lagjes Halilaj, në lagjen Ramaj, dhe në lagjen Xhekaj. Po ashtu kemi kërkesa edhe për rrjetin e kanalizimit në lagjen Halilaj dhe në lagjen të shkolla e fshatit. Kam një kërkesë edhe për Drejtorinë e Shëndetësisë lidhur me ambulanten e fshatit që të funksionalizohet në mënyrë që banorët e fshatit tonë të mos shkojnë për kryerjen e shërbimeve ne Abri ose në Baicë, pasi që është objekti të funksionalizohet dhe të sigurohet stafi shëndetësor.

Fadil Tiku – administratorë i fshatit Vërboc – çdo ditë takohem me banorë të lagjes Rrukiqi dhe ata kanë nevojë të madhe për asfaltimin e rrugës në këtë lagje, ata po kërkojnë të dijë pse nuk po asfaltohet pjesa e mbetur në lagje, për shkak të projektit të liqenit, apo për shkak të mungesës buxhetore. Kemi probleme me rrjetin e kanalizimit, ku shumë lagje edhe pse është kryer, ujërat po vijnë nga Polaci në livadhe tona dhe nga erërat e tyre janë bërë të pa banueshme

disa lagje. Lagja Zhushi ka nevojë për asfaltim, lagja Krelani, po ashtu është e nevojshme të lidhet lagja e Gllareva me pishat në Gllobar.

Afrim Gjeli- administratorë i fshatit Poklek i Ri – e kam dorëzuar një kërkesë me 24 shkurt 2020 në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë dhe në Drejtorinë për Infrastrukturë Lokale, prandaj kërkoj që kjo kërkesë të realizohet, kërkesë tjetër kemi nga banorët e banesave në Poklek të Ri, që këto banesa ende nuk janë të pranuar teknikisht dhe kanë mbetur në pjesë e madhe të pa banuara, po ashtu nuk dihet ende se kush është pronari faktik i tyre dhe banorët kanë mbetur pa e zgjidhur ende çështjen e banimit. Ato objekte nuk janë pranuar asnjëherë teknikisht dhe në të ardhmen munden me paraqit ndonjë rrezik të madh nga tërmetet ose fatkeqësi tjera natyrore. Kisha edhe kërkesë tjetër, në Komoran është e nevojshme të ndahet një parcelë për ndërtimin e objektit të zjarrfikësve, për shkak se është shumë e nevojshme që ajo pjesë të ketë edhe stacionin e zjarrfikësve.

Jahir Beqiqi – administratorë i Denasit II – Drenasi II ka nevojë për asfaltim të 4 rrugëve dhe një trotuar dhe kërkoj që të realizohen këto projekte, po ashtu Drenasi II ka nevojë për një çerdhe, ka qenë e planifikuar, por ende nuk është realizuar, prandaj kisha kërkuar që të realizohen kërkesat tona për vitin e ardhshëm.

Zekë Kluna – administratorë në fshatin Poklek i Vjetër – kisha me e nda një shqetësim lidhur me ujin e thart në Poklek, pse komuna ende nuk ka bërë asnjë investim në atë pjesë, kur duhet rëndësia e atij burimi natyral të ujit. Janë më dhjetëra gjenerata që kanë pi e furinzu me atë burim të ujit në Poklek e nuk i është dhënë rëndësia nga ana e Komunës për të rregulluar, ka mbetur sikur me qenë në një komunë tjetër ajo pjesë. Rruga në lagjen Muqolli nuk është kryer ende, vetëm do zhavor është vendosur dhe ka mbetur ashtu, po ashtu rrjeti i kanalizimit në Poklekun e Vjetër është në gjendje të mjerueshme dhe një pjesë e tyre derdhen direkt në këtë burim të ujit për pije dhe e ka bërë të pashfrytëzueshëm këtë pasuri natyrore që ka fshati jonë, prandaj kisha kërkuar të dilni dhe të rregulloni atë pjesë dhe ti kthehet bukuria atij vendi siç ka qenë më herët.

Fadil Tiku – administratorë i fshatit Vërboc – fshati jonë ka 4 burime të ujit mineral dhe asnjëra prej tyre nuk është e rregulluar dhe kisha kërkuar që të rregullohet ato pjesë e ujit dhe të mbrohen me projekte. Kam bërë kërkesë para dy dite që banorët e fshatit kërkojnë që të punohet në ambulanten e Tërstenikut edhe ditën e shtunë, këtë kërkesë i kam bërë edhe drejtorit të Shëndetësisë, po ashtu kisha dasht të informohem lidhur me projektin e ndërtimit të shkollës pse ka mbetur ai projekt ende në atë gjendje.

Xhevdet Demaku – administratorë i fshatit Abri - prioritet i fshatit tonë është ujësjellësi, prandaj kisha kërkuar të njoftohem se rezervuari me kapacitet 350 ml litra, kur do të përfundohet dhe të realizohet. Prerja e rrugës në lagjen Demaku është për t'u intervenuar shumë shpejtë, kërkesa është bërë ka kohë, por ende nuk është kryer, po ashtu edhe lagja Hysenaj është premtuar se do të asfaltohet, por ajo ende ka mbetur në gjendje të njëjtë. Po ashtu është edhe kërkesa e lagjes Kurtaj për një transformator të energjisë elektrike, së bashku me KEDS-in të sjellët sepse kanë shumë nevojë.

Drejtori i Infrastrukturës Lokale, Ednrit Gllareva – i mora të gjitha kërkesat e juaja të cilat i keni paraqitur në këtë takim dhe ju falënderoj për bashkëpunimin e treguar me organet komunale për të pasur një listë të projekteve kapitale që del direkt nga nevoja dhe kërkesat e qytetarëve. Po fillojmë me kërkesat e fshatit Gllanasellë, asfaltimi në lagjen Nika, këtë vit janë planifikuar të asfaltohen 650 metra, asfaltimi i rrugicës në lagjen Topilla dhe Krasniqi po ashtu edhe kjo përfundon gjatë këtij viti, po ashtu edhe kanalizimi në lagjen Krasniqi do të përfundojë këtë vit, ura në lagjen Nika përfundon këtë vit, ndërsa kërkesat tjera i mora dhe i regjistrova dhe të cilat do të paraqiten në listën projekteve për vitin 2021. Në fshatin Tërstenik II, rruga në lagjen Mulaj përfundon gjatë këtij viti, po ashtu edhe rruga në lagjen Qallapeku edhe një pjesë e rrugicës në lagjen Smakiqi, ndërsa kanalizim për këtë vit janë të planifikuara rreth 2000 metra. Në fshatin Sankoc, kanalizimi në lagjen Ramaj dhe Gjoshi përfundon gjatë këtij viti, gjithashtu edhe kolektorët e ujërave të zeza përfundojnë këtë vit deri në Komoran, ndërsa kemi edhe 600 metra asfaltim për këtë vit në fshatin Sankoc. Në fshatin Kizhnarekë, kanali i ujërave atmosferike përfundon gjatë këtij viti, po ashtu edhe kanalizimi në lagjen Bajraktari përfundon gjatë këtij viti, dhe janë të planifikuara edhe 500 metra asfaltim në këtë fshat. Në fshatin Baicë, asfaltimi në lagjen Vrellaku është në projekt për këtë vit, asfaltimi në lagjen Topalli po ashtu është në projekt këtë vit e po ashtu edhe në lagjen Elshani, ndërsa sa i përket kanalizimit, janë të planifikuara 2000 metra gjatë këtij viti dhe besoj që pjesa më e madhe e fshatit kryhet gjatë këtij viti, ndërsa për pjesë tjera vitin e ardhshëm. Sa i përket fshatit Tërdec, kanalizimi të lagja afër shkollës është në gjendje të keqe, por është në projekt për këtë vit dhe përfundon gjatë këtij viti, rruga në lagjen Halilaj dhe rruga në lagjen Xhekaj janë në projekt për këtë vit. Në fshatin Vërboc në lagjen Rrukiqi nuk është investuar për shkak se është planifikuar ndërtimi i liqenit për grumbullimin e ujit, ndërsa kanalizimi përfundon komplet gjatë këtij viti për gjithë fshatin, ndërsa asfaltimi do të kryhet gjatë këtij viti në lagjen Zhushi si dhe asfaltimi i rrugës që lidh Vërbocin dhe Tërstenikun. Në Poklek të Ri kemi të planifikuar për këtë vit 500 metra asfalt, dhe kanalizim 1 kilometër. Në Drenasin II gjatë këtij viti do të rregullohet 1 kilometër rrugë me kubëza, dhe shumica e lagjeve në Drenasin II do të përfundojnë gjatë këtij viti. Në fshatin Poklek i Vjetër, rruga e lagjes Muqolli është në projekt për këtë vit, e po ashtu është edhe 1 kilometër kanalizim. Në fshatin Abri kemi të planifikuar 2 kilometra kanalizim dhe asfaltimi në lagjen Hysenaj përfundon gjatë këtij viti. Këto janë ato që mora shënime, e që shumica ishin kërkesa nga ana juaj të projekteve që veç janë të planifikuara për këtë vit që kanë dal si kërkesa nga ju kur janë mbajtur dëgjimet buxhetore, ndërsa ato kërkesa të tjera janë marr si shënime dhe do të vendosen në listën e projekteve kapitale për vitin e ardhshëm.

Liridon Sadiku – administrator i Drenasit – Drenasi ka nevojë për një vëmendje më të madhe rreth projekteve kapitale, sepse është qendra, prandaj është mirë që të orientohen projektet e mëdha në qytet, sepse shumica e vendbanimeve tani i kanë të rregulluar kërkesat e tyre emergjente, kanalizim, rrugë e ujësjellës.

Gazmend Hajdini – administrator i fshatit Zabel i Epërm – është mirë që Komuna të planifikoj për vitin e ardhshëm ndriçimin e fshatit e po ashtu edhe disa rrugica në lagje të asfaltohen sepse kanë mbetur në gjysmë. Shtyllat elektrike kanë ardhur, është e gatshme

procedura për t'i vendosur mjetet ndriçuese tani në fshat. Po ashtu edhe një trotuar deri në Komoran sepse nxënësit janë të rrezikuar.

Endrit Gllareva – në fshatin Zabel i Ulët janë të planifikuara 500 metra me asfalt dhe një pjesë e atyre rrugicave do të përfundojnë këtë vit, sa i përket ndriçimit e kemi në buxhet 100 mijë euro dhe një pjesë e atyre mjeteve kalon edhe në fshatin Zabel, po ashtu edhe kanalizimi që janë shfaqur më herët disa probleme të ura do të kryhen gjatë këtij viti dhe fshati do të këtë i gjithi rrjetin e kanalizimit.

Zekë Kluna, administrator në fshatin Poklek i Vjetër – ju kisha kërkuar që të bani një zgjidhje rrjedhës së burimit të ujit të thart në fshat, është një rrjedhë e vjetër e që duhet të ruhet ajo pjesë e të kthehet në gjendjen siç ka qenë, në Ballkan nuk ka ujë më të pastër se i ujë.

Samedin Bylykbashi, administrator në fshatin Baicë – rruga në lagjen afër lagjes Elshani është vetëm një shtëpi dhe duhet një intervenim emergjent për zhavorr, të ju behët një zgjidhje.

Endrit Gllareva – me ujë të pijshëm kemi probleme si Komunë, për shkak të problemeve paraprake që besoj se jeni të njoftuar, por jemi duke bërë përpjekje që të rregullojmë këtë çështje, sidomos gjatë vitit 2021 do të mbetet si prioritet i joni që kjo çështje të zgjidhet. Ndërsa atë rrugën afër lagjes Elshani në fshatin Baicë e kam marr si propozim dhe do të shikojmë mundësitë buxhetore të rregullojmë.

Nazmi Hasi, nënkryetar i Komunës – një sqarim për Zekë Klunën lidhur me burimin e ujit mineral në Poklek, pasi që po insiston, ajo është pronë publike dhe në pronën publike për atë qëllim duhet të investoj nivelin qendror, mirëpo ne nuk kemi një të dhënë shkencore të detajuar, por ata ujë ka një aciditet të lartë dhe prani të hekurit jashtë mase, kështu që është pak problem të investohet në atë pjesë, sepse pastaj duhet të jetë i hapur 24 orë dhe me mbikëqyrje. Mbetet nga ekspertet të bëjnë një hulumtim me të detajuar dhe pastaj edhe të investohet në atë burim të ujit mineral, megjithatë ne po e marrim si propozim dhe do t'i drejtohem nivelit qendror me projekt, por ju kisha lut që të bëni edhe me shkrim kërkesën tuaj.

Imri Bajraktari, administrator i fshatit Kizhnarekë – kisha me pyet drejtorin Endrit lidhur me trotuarin, e kam bërë kërkesën dhe më është kthyer që këtë vit do të kryhet, kisha dasht me e ditë a kryhet ai trotuar këtë vit.

Endrit Gllareva – kërkesën tuaj e kam marr ma herët, por për shkak të pandemisë, ne jemi vonuar me procedura të prokurimit, por e mora si kërkesë dhe do të shikojmë mundësitë buxhetore nëse kemi hapësirë që të përfundojë këtë vit, kemi vetëm 100 mijë euro për trotuare në gjithë Drenasin.

Hysen Avdyly, administrator i fshatit Likoshan – e kam një kërkesë për fshatin tonë për ndriçim pasi që shtyllat janë vendosur, vetëm llapma duhet pra që nuk është ndonjë investim i madh, pastaj kanë mbetur gjysmë edhe 300 metra asfalt të rrugës në lagjen Zymeri, kemi edhe disa lagje të tjera, por këto janë prioritet i fshatit tonë.

Endrit Gllareva – kemi të planifikuar 600 metra asfaltim në fshatin Likoshan dhe besoj që do të kryhet gjatë këtij viti, ndërsa sa i përket ndriçimit për këtë vit nuk kemi të planifikuar, por kërkesa juaj do të merret parasysh për vitin e ardhshëm. Por nëse mundeni si lagje me u organizu me hy në bashkëfinancim me Komunën, ju me i rregullu ndriçimin, ndërsa ne e bëjmë pagesën e faturave dhe orën e paguajmë ne si Komune.

Bajram Qallapeku, administrator i fshatit Tërstenik II – banorët po donë me e ditë se a ka një datë të caktuar se kur do të rregullohet ujësjellësi në fshatin tonë dhe ne të kemi ujin e pijes.

Endrit Gllareva – e përmenda edhe më herët, por edhe kryetari në takimin që e patëm, ju tregoi që kemi probleme me gypat që nuk janë vendosur në Kamenicë në shumë vende, por ne pasi që të kryhen procedurat e hetimeve, me prioritet do të rregullojmë këtë çështje gjatë këtij viti dhe vitin e ardhshëm dhe besoj që do të përfshihen të gjitha vendbanimet që janë planifikuar në rrjetin e ujësjellësit. Pra pa e dhënë fjalën e fundit hetuesia, ne nuk mundemi me fillu me këtë projekt.

Fadil Tiku, administrator i fshatit Vërboc – me projektin për meremetim të shtëpive dhe fasadeve që ka qenë thirrja para tre muajve për të përfituar ekonomitë familjare për të kursyer energjinë elektrike, qa u ba me këtë projekt se kemi shumë kërkesa nga banorët.


Nazmi Hasi, nënkryetar i Komunës – për shkak të pandemisë, është shtyrë procesi në realizmit të këtij projekti, ju e dini që ky projekt është i mijëvjeçarit, pra projekt amerikan, projekti nuk është anuluar, por është prolonguar për momentin për shkak të gjendjes së pandemisë dhe varësisht nga situata, projekti do të vazhdoj, kam kontaktuar me përgjegjësit e këtij projekti dhe me kanë njoftuar se momentin që kanë diçka konkrete do të vazhdohet me realizimin e tij, e rëndësishme është që projekti nuk është anuluar dhe do të realizohet ashtu siç kanë premtuar donatorët e mileniumit.

Muhamet Gjoka, drejtor i Arsimit – nga ky dëgjim buxhetor u adresuan dy pyetje për Drejtorinë e Arsimit, njëra ishte për ndërtimin e çerdhes në Drenasin II, ju kisha njoftuar se këtë vit do të filloj ndërtimi i një çerdhe donacion nga Bashkimi Evropian dhe do të jetë një objekt me standarde të BE-së, objekti do të ndërtohet në oborrin e shkollës Rasim Këçina, po ashtu planifikojmë edhe një objekt tjetër në Komoran. Në takimin e fundit që kemi pasur me Ministrinë e Arsimit, kemi paraqitur kërkesën për nevojën e ndërtimit të çerdheve të tjera dhe shpresojmë që kërkesa jonë të realizohet, sepse nevojat janë të mëdha. Pyetja e dytë është lidhur me projektin e aneksisit të shkollës në fshatin Vërboc, ju kisha njoftuar se këto ngecje janë bërë për shkak të gjendjes së pandemisë, qysh në muajin Shkurt kemi diskutuar me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik që janë investitor, por për shkak të gjendjes janë vonuar me procedura, me njoftimin e fundit që kemi marr edhe me miratimin e buxhetit, na kanë njoftuar se shumë shpejt edhe do të fillojnë me procedurat e prokurimit që ky objekt të rregullohet ashtu siç është i planifikuar.

Bekim Dobra- ju kisha falënderuar të gjithë të pranishmit që keni dhënë kontributin e juaj në këtë dëgjim buxhetor, ky është diskutimi i parë buxhetor që po mbahet, pasi të miratohet në mbledhjen e Kuvendit të Komunës Korniza Afatmesme Buxhetore, dëgjimet buxhetore do të zhvendosen në vendbanimet tuaja dhe për këto dëgjime do të njoftoheni me kohë për datën, vendin e orën e mbajtjes së dëgjimeve, po ashtu këtu nuk përfundojnë kërkesat tuaja, ato mund t'i adresoni edhe përmes formës së shkruar në Drejtori. Faleminderit shumë për bashkëpunimin tuaj dhe pjesëmarrjen.



Procesmbajtësi:


Bekim Dobra



Kryetari i Komunës


Ramiz Lladrovci